

MENAXHIMI I QËNDRUESHËM I UJIT PËRBALLË *Ndryshimeve Klimatike*

KONFERENCA DHE EKSPOZITA E 13-TË E PËRBASHKËT BALLKANIKE



**THIRRJE PËR
ABSTRAKTE**
11-12-13 NËNTOR 2025
DURRËS, SHQIPËRI



SHUKALB
SHOQATA UJËSJELLËS KANALIZIME E SHQIPËRISË



SHUKOS
SHOQATA E UJËSJELLËSVE DHE KANALIZIMIT TË KOSOVËS

Konferenca dhe Ekspozita:
Programi i Konferencës:
Tel SHUKALB:
Tel SHUKOS:

info@BalkansJointConference.org
program@BalkansJointConference.org
+355 42 245 101, Mob: +355 69 6012782
+383 38 600 873, Mob: +383 44 182 497, +383 44 282 580



MIRËSEARDHJA

SHUKALB dhe SHUKOS kanë kënaqësinë t'ju ftojnë të bashkoheni me ne në **Konferencën dhe Ekspozitën e 13-të të Përbashkët Ballkanike**, e cila do të zhvillohet në **datat 11 – 13 Nëntor 2025**, në qytetin bregdetar të **Durrësit**, në **Shqipëri**, në **Grand Blue Fafa Resort**.

Tema e konferencës së këtij viti **“Menaxhimi i qëndrueshëm i ujit përballë ndryshimeve klimatike”**, adreson një nga sfidat më urgjente mjedisore të kohës tonë. Ndryshimet klimatike tashmë po ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në disponueshmërinë, cilësinë, dhe shpërndarjen e ujit, duke prishur ekosistemet dhe kërcënuar qëndrueshmërinë e komuniteteve në të gjithë rajonin.

Menaxhimi i qëndrueshëm i ujit po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm ndërsa vendet e Ballkanit bëhen më të prekshme ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike, duke përjetuar ngjarje më të shpeshta ekstreme të motit. Në të njëjtën kohë, shumë Kompani Ujësjellës Kanalizime (UK) në rajon vazhdojnë të përballen me sisteme të vjetëruara, humbje të mëdha të ujit dhe kapacitete të kufizuara për t'iu përgjigjur këtyre sfidave, duke e bërë më të vështirë ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe ujërave të ndotur.

Ndërsa vendet e Ballkanit shkojnë drejt integritimit në BE, kompanitë UK përballen me një provë kritike: Përmbushjen e direktivave të BE-së për ujin dhe ndryshimet klimatike. Kompanitë UK duhet të kuptojnë dhe të përshtaten me një sërë rregullash të reja, të modernizojnë infrastrukturën e vjetëruar në përputhje me standarde të larta mjedisore dhe të sigurojnë investime të konsiderueshme për të mbështetur këto ndryshime. Nga ana tjetër, kalimi drejt teknologjive të përparuara dhe praktikave të qëndrueshme ndaj klimës kërkon aftësi të reja, institucione më të forta dhe kapacitete më të mëdha operationale. Duke u përballur me këto sfida drejtpërdrejt, kompanitë UK mund t'i shndërrojnë këto presione në progres dhe aftësi për t'u përshtatur me një klimë që ndryshon me shpejtësi.

Ndër vite, Konferenca e Përbashkët Ballkanike ka fituar një reputacion për ofrimin e një programi me përmbajtje me cilësi të lartë, siç pasqyrohet edhe në komentet e vazhdueshme pozitive nga pjesëmarrësit. Edhe për këtë vit, ne ju inkurajojmë të rishikoni temat dhe fushat kryesore të programit dhe të kontribuoni duke paraqitur një abstrakt për prezantim.

Ju mirëpresim në Nëntor në Durrës, për të punuar së bashku drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme të ujit në rajonin e Ballkanit.

KOMITETI I PROGRAMIT TEKNIK

Komiteti i Programit Teknik përbëhet nga profesionistë me përvojë në sektorin e ujit nga Shqipëria dhe Kosova. Komiteti siguron që programi i konferencës të paraqesë përmbajtje me cilësi të lartë, të përshtatshme dhe të mirë ekuilibruar, përmes një procesi vlerësimi. Komiteti i Programit Teknik përbëhet nga këta anëtarë:

Abedin Azizi

Zëvendës Drejtor, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, Kosovë

Amir Rexha

Specialist i GIS-it, Kompania Rajonale e Ujësjellësit Hidromorava, Kosovë

Arbana Kola (ex officio)

Menaxhere Projekti, Shoqata Ujësjellës Kanalizime, Shqipëri

Armend Avdiu

Drejtor Teknik, Kompania Rajonale e Ujësjellësit Prishtinë, Kosovë

Edona Kraja

Drejtoresh Tregtare, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër, Shqipëri

Enkelejda Gjinali

Lektore, Departamenti i Inxhinierisë së Mjedisit, Universiteti Politeknik i Tiranës, Shqipëri

Fahri Asllani

Përgjegjës i Burimeve Njerëzore, Kompania Rajonale e Ujësjellësit Gjakova, Kosovë

Fatime Imeraj

Sekretare e Përgjithshme, Enti Rregullator i Ujit, Shqipëri

Ilir Rodiqi

Lektor, Fakulteti i Ndërtimtarisë, Kosovë

Jovan Gjika

Koordinator Projektesh, Agjencia Kombëtare Ujësjellës-Kanalizime, Shqipëri

Nadire Vitija (ex officio)

Menaxhere e Trajnimeve dhe Zhvillimit Profesional, Shoqata e Ujësjellësve dhe Kanalizimit, Kosovë

Rozarta Pura

Shefe Kabineti dhe Drejtore e Burimeve Njerëzore, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës, Shqipëri

TEMAT KRYESORE TË KONFERENCËS

Folësit e interesuar duhet të paraqesin një abstrakt që fokusohet në njërin nga temat e mëposhtme. Të gjitha abstraktet e dorëzuara do të vlerësohen nga Komiteti i Programit. Autorët e abstrakteve të pranuar do të ftohen të përgatisin dhe të paraqesin një punim të plotë së bashku me një prezantim në PowerPoint. Abstraktet mund të mbulojnë, por nuk kufizohen vetëm në temat e mëposhtme:

QEVERISJA DHE POLITIKAT PËR SHOQËRITË UK

- Zhvillimi i Politikave për Qeverisjen e Shoqërive UK dhe Marrëdhëniet Institucionale
- Përzgjedhja, Krijimi dhe Funksionimi i Bordeve Mbikëqyrëse
- Drejtimi Menaxherial i Shoqërive dhe Organizimi Struktural
- Rajonalizimi i Shërbimeve UK dhe Zbatimi i Marrëveshjeve për Sigurimin e Shërbimit
- Qeverisja e Korporatave
- Partneriteti Publik Privat
- Marrëdhënia midis Shoqërive UK dhe Pushtetit Vendor
- Menaxhimi i Sistemeve Rurale dhe të Vogla

KUADRI RREGULLATOR

- Licencimi i Shoqërive UK
- Procesi i Shqyrtimit dhe Miratimit të Tarifave
- Analiza e Performancës së Shoqërive UK
- Zhvillimi dhe Aplikimi i Standardeve të Shërbimit

MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE

- Kapacitetet për Thithjen e Investimeve Kapitale në Vendet në Zhvillim
- Metodat e Vlerësimit të Situatës Aktuale dhe Prioritizimi i Nevojave të Investimeve
- Zhvillimi i Masterplaneve Dinamike
- Monitorimi i Investimeve dhe Qëndrueshmëria e tyre në kohë

MENAXHIMI I BURIMEVE UJORE

- Ndryshimet Klimaterike
- Balancimi i Kërkesës për Ujë me Zhvillimin e Burimeve të Reja
- Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore
- Monitorimi dhe Mbrojtja e Burimeve Ujore
- Ujërat Ndërkufitare
- Menaxhimi i Thatësirave dhe Përmbytjeve

MENAXHIMI FINANCIAR I SHOQËRIVE UK

- Burimet e Financimit dhe Politika e Subvencioneve
- Menaxhimi i Riskut Financiar
- Hartimi, Zbatimi dhe Monitorimi i Planeve 5 vjeçare të Biznesit
- Raportimi Financiar për të Mbështetur Përmirësimin e Performancës
- Instrumentet për Kontrollin e Brendshëm
- Menaxhimi i Borxhit

MENAXHIMI I OPERIMIT DHE MIRËMBAJTJES NË SHOQËRITË UK

- Vlerësimi i Analizës së Kërkesës për Ujë
- Praktikat e Matjes së Konsumit të Ujit
- Zvogëlimi i Humbjeve të Ujit, Praktika dhe Përvoja
- Planifikimi Inxhinierik dhe Dixhitalizimi i Zonës së Shërbimit (GIS)
- Aplikimi i Modeleve Hidraulike, Praktika dhe Përvoja
- Rritja e Përdorimit të Sistemit SCADA, për Operimin e Sistemeve të Ujësjetësave
- Menaxhimi i Sigurisë së Ujit dhe Krizave
- Benchmarking
- Efienca e Energjisë në Shoqëritë UK
- Menaxhimi i Integruar i Aseteve të Shoqërisë
- Siguria dhe Shëndeti në Punë

MENAXHIMI I UJIT TË NDOTUR DHE LLUMIT

- Uji i Ndotur në Kontekstin e Ekonomisë Qarkulluese
- Qeverisja dhe Politikat për Ujin e Ndotur
- Ndërtimi dhe Operimi i Impianteve të Trajtimit të Ujit të Ndotur
- Sistemet dhe Sfidat e Ndërtimit të Impianteve të Trajtimit të Ujit të Ndotur
- Zgjedhja e Teknologjisë së Trajtimit për Sistemet e Vogla dhe Rurale
- Trajtimi i Llumit dhe Ripërdorimi
- Përdorimi i Llumit për Prodhimin e Energjisë

SHËRBIMI NDAJ KLIENTIT

- Efienca Komerciale
- Organizimi dhe Funksionimi i Departamentit të Shërbimit me Klientin
- Menaxhimi i Bazës së të Dhënave të Konsumatorit
- Kontratat e Shërbimit me Klientin
- Menaxhimi i Marrëdhënieve dhe Komunikimit me Publikun
- Përdorimi i GIS për Menaxhimin e Ankesave të Klientëve
- Zbatimi i Politikave për Ndërprerjen e Shërbimit në rast Mospagese

MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Politika e Punësimit
- Vlerësimi i Nevojave për Trajnime dhe Zhvillimi i Kapaciteteve
- Trajnimi dhe Certifikimi i Bazuar në Testim
- Vlerësimi Vjetor i Performancës së Punës së Stafit

UDHËZIME TË PËRGJITHSHME MBI DORËZIMIN E ABSTRAKTIT

Autorët që do të dorëzojnë abstraktet deri më datën **12 Shtator, 2025**, duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- Abstraktet mund të dorëzohen në gjuhët Shqip dhe/ose Anglisht
- Format i abstraktit duhet të jetë sipas këtyre specifikimeve:
 - deri në 350 fjalë
 - dokument "MS Word"
 - shkronja Times New Roman, 11pt.
- Abstraktet duhet të përfshijnë këtë informacion:
 - Titullin e Materialit/Prezantimit
 - Emrin e Autorit/ Pozicionin e tij/ Institucioni/ Shteti
 - Kontaktet personale (e-mail, adresë postare dhe numër telefoni).
- Temën e Konferencës së cilës i referohet
- Qëllimin e punimit, çështjet/problemet kryesore, metodologjin e përdorur rezultatet dhe përfundimet e nxjerra.

Për informacion më të detajuar mbi dorëzimet e abstrakteve dhe udhëzime të tjera, vizitoni faqen e [Rregullave dhe Udhëzimeve](#) në faqen e internetit të Konferencës.

DATAT KRYESORE DHE GJUHËT ZYRTARE TË KONFERENCËS

Dorëzimi i Abstrakteve	12 Shtator, 2025
Pranimi /Konfirmimi i Abstrakteve	26 Shtator, 2025
Programi i Avancuar	24 Tetor, 2025
Dorëzimi i Prezantimeve PowerPoint Dorëzimi i Biografisë	27 Tetor, 2025
Dorëzimi i Punimeve Finale ¹	24 Nëntor, 2025

Konferenca do të zhvillohet në gjuhët Shqip dhe Anglisht.

Përkthimi simultan do të sigurohet përgjatë gjithë ditëve të organizimit të konferencës.

KONTAKTET

Për më shumë informacion rreth Programit Teknik:

E-mail: program@balkansjointconference.org

Website: <https://balkansjointconference.org/>

Arbana Kola (SHUKALB): Tel: +355 42 245 101; Mob: +355 69 58 39 139

Nadire Vitija (SHUKOS): Tel: +383 38 600 873; Mob: +383 44 182 497

¹ Punimet e plota duhet të dorëzohen duke përdorur [shembullin referues](#) dhe duhet të përmbushin të gjitha kërkesat për formatin dhe përmbajtjen. Libri i Punimeve do të publikohet vetëm në raste se dorëzohen të paktën 10 punime të plota që plotësojnë këto kriteret.